



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT
PRISHTINË

Në bazë të nenit 28, paragrafi 2 të Ligji nr. 04/l-138 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional dhe në bazë të, nenit 12, paragrafi 1 të Ligjit nr. 04/l-143 për Arsimin dhe Aftësimin për të rritur në Republikën e Kosovës:

Drejtoria e Arsimit
Shpall

K O N K U R S

Për regjistrimin e vijuesve të rritur në arsimin e mesëm të lartë të arsimit profesional-klasa X:

Nr.	Shkolla	Nr.i paraleleve	Nr. i nxënësve	Lëmia dhe profili	Gjithsej
1	SHMT "28 Nëntori"	1	25	Ndërtimtari	25
		1	25	Arkitekturë	25
		1	25	Gjeodezi	25
		1	25	PTT	25
		1	25	Grafikë	25
	Gjithsej	5	25		125
2	SHMEJ "Hoxhë K. Prishtina"	1	32	Ekonomik: banka e sigurime	32
		1	32	Administratë: asistent i administratës	32
		1	32	Administrim biznesi: financa	32
	Gjithsej	3	32		96

3	SHMHT "7 Shtatori"	1	15	Turizëm: asistent i turizmit	15
		1	15	Hotelieri: asistent i restorantit	15
		1	15	Hotelieri: gjellëbërës	15
		1	15	Tregti me pakicë-shumicë	15
Gjithsej		4	15		60
4	SHMAT "Abdyl Frashëri"	1	20	Bujqësi: hortikulturë	20
		1	20	Bujqësi: mbrojtja e bimëve	20
		1	20	Agrobiznes	20
		1	20	Furrtari	20
		1	25	Përpunues i ushqimit dhe profesionet e ngjashme	25
		1	20	Veterinë: veterinari	20
Gjithsej		6	20/25		125
5	SHME "Gjin Gazulli"	2	32	Teknik i informatikës	64
		1	32	Teknik i telekomunikacionit	32
		1	32	Energjetikë	32
Gjithsej		4	32		128
Total		22			534

-REGJISTRIMI I VIJUESVE NË PROGRAMIN "Arsimi për të rritur", bëhet sipas procedurave të njëjta të regjistrimit për nxënësit e rregullt, siç është paraparë në Ligjin nr. 04/L-143 për Arsimin dhe Aftësimin për të rritur në Republikën e Kosovës dhe Udhëzimeve Administrative të MASHT-it.

Në programin "Arsimi për të rritur" në shkollat e mesme të larta, vijuesve ju mundësohet që një vit të plotë shkollor ta përfundojnë në afat prej 18 javë mësimi (UA nr. 40/2006 MASHT).

Të drejtë regjistrimi kanë të gjithë të interesuarit, të cilët kanë kaluar moshën për të qenë nxënës të rregullt.

Dokumentet e nevojshme për regjistrim:

1. Dëftesat e klasave të kryera paraprake
2. Certifikata e lindjes
3. Pagesa

Shkollimi në nivelin e arsimit të mesëm të lartë është me pagesë. Participimi bëhet në bazë të Rregulloren nr. 01/2017, dt. 02.02.2017 Për planifikimin dhe shpenzimin e të hyrave vetanake të realizuara nga institucionet e arsimit dhe aftësimin profesional dhe arsimit për të rritur, Rregullores për të hyra vetanake të institucioneve arsimore të Komunës së Prishtinës: 01. nr. 110 - 157460, dt. 01.07.2014.

Pagesa e regjistrimit për vijuesit e arsimit për të rritur:

- a) për regjistrim të vitit (për një klasë 100 €)100 €;
- b) për praktikë profesionale50 €;
- c) provim diferencial 10 €;
- d) provimi përfundimtar, certifikatën-diploma 50 €;

Pagesat bëhen në institucionet përkatëse edukativo-arsimore sipas kodeve të shkollave. Vijuesit, të cilët ndërrojnë profilin, do t'u nënshtrohen provimeve diferenciale, bazuar në UA 16/2011, dt. 30.12.2011 të MASHT-it.

Kandidatët, të cilët ndërrojnë drejtimin, janë të obliguar që paraprakisht t'u nënshtrohen provimeve plotësuese dhe diferenciale.

Dhënia e provimeve plotësuese dhe diferenciale bëhet në afat të veçantë nga vijimi i klasës, për të cilën kandidati është paraqitur për regjistrim.

Dëftesat dhe diplomat që merren në programin "Arsimi dhe aftësimi për të rritur" janë të barasvlershme me diplomat e arsimit formal.

Konkursi është i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik.

Prishtinë, 05 tetor 2018